

AKT THEMELIM DHE STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“QEVANI TECHNOLOGIES” SHPK

Në Tirane, sot më datë 08.06.2018, unë shtetësja :

Znj. Xhevo Kevani, e bija e Faslliut, 25.08.1946, lindur ne Berat dhe banuese ne Tirane, Rr. Elbasanit, Blloku i Vilave Amerikane, Shtepi Private, Shtetase Shqiptare, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar sipas kartes se identitetit nr. 029346677. Me çilesine e ortakes se vetme kam themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “Qevani Technologies” mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ligjin 9723 date 03.05.2007 “Për Qendren Kombetare te Regjistrimit”, si më poshtë :

KREU I

Neni 1

Shoqeria “Qevani Technologies” Shpk, eshte person juridik i te drejtes Shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Emrat Tregtar të shoqërisë janë : AICORP - AIC DEFENCE & SECURITY - A I COM - INTRA CO.

Neni 3

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria “Qevani Technologies” Shpk, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaket themelues” te cilet nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortaku gezon kuoten e tij ne shoqeri, ne perpjestim me kontributin qe ka dhene ne kapital.

Neni 4

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Autostrada Tirane - Durres, Km.2, 1050. Tirane Albania.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te ortakut te vetem.

Neni 5

Objektivi i Veprimtarise

Tregtimin me shumice e pakice, import eksport, projektim, furnizim, instalim, zhvillim e asamblim dhe mirëmbajtje të paisjeve dhe sistemeve; elektronike, kompiuterike, telefonike, kancelarike, pagesave elektronike, mekanike, fibër optike, ndërlidhje, elektrike, energjitike, telekomunikacionit, teknologjisë së informacionit, inteligjencës, mbrojtjes dhe sigurisë, ushtarake, mallrave ushtarake dhe mallrave për përdorim të dyfishtë, automjete speciale për përdorim të veçantë dhe tregti e përgjithëshme; kryerjen e shërbimeve të ndryshme informatike, telefonike, teknike, interneti, programe kompjuterike, zgjidhje teknologjike. Menaxhim projektsh, mbikëqyrje, konsulencë dhe asistencë logjistike, teknike, ekonomike e ligjore ne fushat e mesiperme; investim, shitblerje, qeramarrje dhe qeradhënje të objekteve dhe pasurive të padundshme për llogari te shoqërisë.

Neni 6

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pa kufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 7

Kapitali Themeltar

- Kapitali themelor i shoqerise tregtare "Qevani Technologies" SHPK eshte 100.000 lek i investuar ne masen 100% te Ortakes se Vetme.
- Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 kuote, te gjitha te nenshkruara dhe te shlyera.
- Kontributi i ortakes mund te jete ne para ose ne menyre (pasuri te lujashme/te paluajshme apo te drejta).
- Ortakja pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime, nepermjet emertimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se administratorit.

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshim te statutit.

Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrimin nga administratori, ne perputhje me nenin 68/5 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendren Kombetare të Regjistrimit".

Neni 9

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e te drejtave qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes
- c) Trashgimnise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRSE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skenen e shoqerise.

Ortaku i Vetem, vendos per ceshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b) Emertimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise veprimtarise
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- c) Investime
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pa vleshme. Shoqeria nuk mund ti kunderjtoje pavleshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesimin, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur djeni per pavleshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur djeni per te.

Neni 11

Administrimi

Administratore e shoqerise eshte Znj. Anisa Kevani, e bija e Kadriut, dtl: 07.03.1987, lindur ne Gramsh dhe banuese ne Tirane, Rruga e Elbasanit, Blloku i vilave, shtepi private, shtetase Shqiptare, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar sipas kartes se identitetit nr. 029346547.

Administratorja e shoqerise do te ushtroje kopetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar mete drejte ripërteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakes se vetme te shoqerise. Administratori i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 12

Kopetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administratorit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortakja e vetme.
- b) Perfaqesoje shoqerine tregtare.
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dekontacioneve dhe te librave kontabel te shoqerise.
- d) Pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjitheshme per miratim.
- e) Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarvajtjen e veprimtarise dhe kzistencen e shoqerise.
- f) Kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportoje perpara asamblese se pergjitheshmene lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarise te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbedhjen e ortakut te vetem edhe në rast kur;

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitet e shoqerise nuk i mbuljne detyrimet e kerkuara brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tij, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe ka vlere me te larte se 5% "per qind" te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administrator ika te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshire ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve, bankave e te gjithe niveleve etj. Administratori ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kopetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Neni 13

Pergjegjësitë

Administratori është pergjegjes individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marreveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marreveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17, 18 të ligjit për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet :

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi ceshtjet, për të cilat merret vendim.
- d) Të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, përzemë apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë.
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrimeve të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet personale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar të demshperblejë shoqërisë demet, që i rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të marrë rregullt. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, atëherë përgjigjet ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në të, administratori është i detyruar të demshperblejë demet e shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interesat apo dividendet
- c) U shpërndan aktivet shoqërisë
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
- e) Jep kredi

Neni 14

Bilanci i Shoqërisë dhe Dividentet

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e Ortakut të Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga administratori. Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zgjidhur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikon ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti kap er detyre qe te kontrolloj te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte i ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe pe rate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut te vetem per ti shqyruar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimi e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e tij
- b) Me vendim te ortakut te vetem
- c) Me hapjen e procedurave te falementimit
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43, te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) Me vendim te gjykates

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidator dhe shenaur ne cdo dekument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e siper". Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguase, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujdusit e emeruar nga Ortaku i Vetem.

Nese Ortaku i Vetem nuk merre nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij. Nese shoqeria emeron me shume se nje lekuidues, pervec kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkarisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posacme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut dhe administratorit.

Neni 19

Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e ti kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne canstin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjere, ndersa ne shoqerite aksionere apo nga ato me pergjegjesi te kufizuar miratohen nga asambleja e pergjitheshme.

Neni 20

Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te miratuara, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, "per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 21

Bashkimi

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet :

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njerës ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthirura, te nje shoqeri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuatave te ketij shoqerie. Ky proces quhet bashkim perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek i cili kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerise ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuatave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqerie te re.

Neni 22

Ndarja

1. Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Ortakut te Vetem, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901, date 14.04.2008.
3. Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritese dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e ketij te fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te regjistrimit ka si pasoje :
Kalimin te shoqerise pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta.

Berjen e aksionereve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionere apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes.

Vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe cregjistrimin e tij nga Qendra Kombetare e regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, "per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vete ligjore, nepermjet shnderrimit te tij ne shoqeri aksionere. Shndrrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar. Per sa nuk parashikohen ne kete statut, do te zbatohet dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Kodit Civil dhe cfare do ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te lindre midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita Perfundimtare

Ky Akt Themelim dhe Statut u redaktua nga une "ortaku i vetem" ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen Shqipe me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

ORTAKJA E VETME

XHEVO KEVANI

